



Planuar / Dorezuar Puniljeno/Prodato Received/Delivered	04.07.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMST/00	3893	2022	1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.442/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi- Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, me Rushit Kajtazi - Zyrtar i lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.442/2022,të datës 06.05.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi,

kundër organit të punësimit/Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në çështjen juridike "transferim", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 04.07.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.442/2022, e datës 06.05.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. MBETET në fuqi Vendimi me Nr. 66/2022 me numër protokolli 1555/2022 i datës 12.04.2022 i Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit.

A r s y e t i m

Ankuesi me datë 06.05.2022, me numër protokolli 2642/2022, ka parashtruar ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore, kundër Vendimit me Nr. 66/2022 me numër protokolli 1555/2022 të datës 12.04.2022 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 16.05.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Ndërsa Këshilli me datë 30.05.2022, ka pranua nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit përgjigjen në kërkesë me numër protokolli: 3149/2022, se bashku me shkresat e bashkangjitura.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pas kërkesës së Kryetarit të Kolegjit për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, më datë 17.06.2022 ka nxjerr Vendim VK.nr.60/2022 me të cilin ka vendosur për shtyrjen e afatit për vendosje për dhjetë (10) dite punës për ankesën e ankuesit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike ,për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën A Nr. 442/2022, e datës 06.05.2022, e parashtruar nga ankuesi me numër protokolli 2642/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kontrata e marrëdhënies së punës e datës 04.03.2008; Akt Emërimi i datës 04.01.2012; Kërkesë e datës 16.05.2014; Vendimi i datës 16.05.2014, me numër protokolli 2115, i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit; Vendimi i datës 21.08.2020, me numër protokolli 2855, i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit; Vendimi A. Nr. 128/2019, i datës 09.12.2020, i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 12.04.2022, me numër protokolli 1555, i Z. V, Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit; Kërkesë e datës 10.02.2014; Vendimi i datës 08.02.2019, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Akt Emërimi i datës 12.10.2010; Akt Emërimi i datës 28.05.2014; Vendimi i datës 16.05.2014; Formuari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2020; Akt emërimi i datës 12.10.2020; Përgjigje në ankesë e datës 30.05.2022, me numër protokolli 3149/2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pabazuar, sepse:

Nga provat e lëndës, shihet që ankuesit fillimisht në bazë të Akt Emërimit të datës 04.01.2012 ka qenë i punësuar në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në pozitën Udhëheqës i Divizionit të Personelit, mirëpo më datë 15.05.2014 ka parashtruar kërkesë tek Sekretari i Përgjithshëm përmes të cilës ka kërkuar të transferohet në një pozitë të barasvlershme në pajtim me Rregulloren Nr. 06/2010 për Transferimin e Nëpunësve Civil për shkak të angazhimeve familjare, dhe nevojës për ngritje profesionale.

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, më datë 16.05.2014 ka nxjerr Vendim me Nr.943/2014 përmes të cilin ankuesin e ka transferuar në pozitën Këshilltar Muzeor në Muzeun e Kosovës, ndërsa më datë 21.08.2020 Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka nxjerr Vendim me Nr. 799/2020 përmes të cilit ka shfuqizuar Vendim me Nr.943/2014 e datës 16.05.2014, dhe ankuesin e ka sistemuar në pozitën Udhëheqës i Divizionit të

Arteve Skenike, Muzikore dhe Pamore. Në arsyetim të këtij vendimi thuhet që transferimi i ankuesit është bërë në mënyrë të kundërligjshme.

Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, më datë 12.04.2022 ka nxjerr Vendim me Nr.66/2022 përmes të cilit ka anuluar Vendim me Nr. 799/2020, duke e kthyer ankuesin në pozitën Këshilltar i Lartë Muzeor në Muzeun e Kosovës, me arsyetimin që Vendim me Nr.943/2014 është shfuqizuar pas pesë (5) vitesh dhe pala kundër këtij vendimi nuk ka parashtruar asnjëherë ankesë.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.66/2022 të datës 14.06.2022 të Zëvendësuesit i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, pretendon që ky vendim është nxjerr si rezultat i shkeljeve të dispozitave procedurale dhe ligjore, konstatim jo të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim i gabuar i ligjit material.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë së Vendimit me Nr.66/2022 të datës 14.06.2022 të Zëvendësuesit i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ka konstatuar që edhe pse ankuesi ka bërë kërkesë për transferim në pozitë të barasvlershme në pajtim me Rregulloren Nr.06/2010 për Transferimin e Nëpunësve Civil, i njëjti kundër Vendimit me Nr.943/2014 të datës 16.05.2014 të Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për transferim të tij, nuk ka parashtruar asnjëherë ndonjë ankesë tek organet kompetente, edhe pse realisht këtij vendimi i kanë munguar elementet e aktit administrative, mirëpo edhe përkundër kësaj ankuesi ka mund të kontestoj këtë vendim. Bazuar në praktiken vendimmarrëse të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është bërë mbi bazën e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës i cili ka qenë i aplikueshëm në kohën e transferimit të ankuesit, neni 4 paragrafi 1 i këtij ligji ka përcaktuar se: *"Në bazë të këtij ligji, statusi i nëpunësit civil nuk aplikohet për kategoritë e mëposhtme: stafi mësimor i sistemit arsimor, stafi mjekësor i sistemit shëndetësor, krijuesit dhe përformuesit e artit..."*, mbi bazë të kësaj ankuesit me rastin e transferimit në pozitën Këshilltar Muzeor, në Muzeun e Kosovës, dhe themelimit të kësaj marrëdhënie punës ka humbur statusin e shërbyesit civil.

Vendimi me Nr.943/2014 i datës 16.05.2014 i Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, është shfuqizuar në bazë të Vendimit me Nr. 799/2020 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit të datës 21.08.2020, pas një periudhë prej më shumë se pesë (5) vitesh nga koha e nxjerrjes së tij, rrjedhimisht Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, thekson që Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, gjegjësisht neni 58 paragrafi 1 ka përcaktuar se: *"Anulimi apo shfuqizimi, në çdo rast tjetër mund të bëhet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur organi publik i përcaktuar sipas paragrafit 1 të nenit 53 të këtij Ligji, njihet me faktet që justifikojnë anulimin apo shfuqizimin, por jo me vonë se pesë (5) vjet nga njoftimi i aktit administrativ"*, në kuptim të kësaj Kolegji, vlerëson se Vendimi me Nr. 799/2020 i datës 21.08.2020 i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit është në kundërshtim me afatet e përcaktuar me këtë nen sepse i njëjti është nxjerr në afat

prej më shumë se gjashtë (6) vitesh nga hyrja në fuqi e Vendimit me Nr.943/2014 të datës 16.05.2014 të Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Vendimi me Nr.66/2022 i datës 14.06.2022 i Zëvendësuesit i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, është nxjerr në pajtim me nenin 48, nenin 53 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"1.Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, sipas detyrës zyrtare, nga organi publik që ka kompetenca të nxjerrë aktin, nga organi i tij mbikëqyrës apo nga një organ tjetër i përcaktuar shprehimisht me ligj. 2. Anulimi i një akti administrativ ka pasoja në të kaluarën (retroaktive), ndërsa shfuqizimi i aktit administrativ ka pasoja vetëm në të ardhmen. Anulimi edhe shfuqizimi mund të jenë të pjesshëm apo të tërësishëm"*, nenin 55 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"Një akt administrativ i paligjshëm për arsye të tjera nga ato ta parapara nga neni 54 i këtij Ligji, mund të anulohet apo të shfuqizohet, me qëllimin për të vendosur ligjshmërinë"*, ndërlidhur me nenin 58 paragrafi 2 të këtij ligji, bazuar në këtë pretendimet ankimore të ankueses janë të pabazuara.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafit 2 të Ligjit Nr.05/L-031 Për procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.442/2022

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

